



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Prodato Received / Delivery	16.01.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRIMSHACK	361/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1073/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1073/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 23.11.2022, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1073/2022 e datës 01.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 23.11.2022.

A r s y e t i m

Ankuesja, me datë 01.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7519/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1078/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 23.11.2022, me pretendimet ankimore së vendimi në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa lidhur me kandidatin e vetëm i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar ankesën për

përgjigje në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ndërsa me datë 21.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 01.12.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 01.12.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigje në kërkesë e datës 21.12.2022; Vendimin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 23.11.2022; Njoftimin e datës 24.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 18.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Konkursin e datës 07.10.2022; pasqyrën e llogarisë trustit i datës 23.11.2022; Shkresën e datës 02.11.2022; Vërtetimin e datës 01.10.2022; Vendimin për themelimin e Komisionit të Vlerësimit i datës 02.12.2022; Akt emërimit e datës 14.01.2019; Akt emërimit e datës 30.09.2013; Akt emërimit e datës 14.08.2013; Akt emërimit e datës 23.04.2013; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës i datës 08.06.2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës i datës 02.12.2022; Vendimin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 23.11.2022 me shifër RAN0008853; Vendimin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 18.11.2022 me shifër RAN0008799; Vërtetimin e datës 01.04.2022 të Noterit; Vërtetimin e datës 02.07.2020 të Avokatit; Vendimin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 24.11.2022 me shifër RAN0008799; Diplomën e datës 01.12.2020 me numër:3462/1220; Shkresën e noteriuar me numër:11685/2022; Çertifikatën e datës 23.03.2012; Çertifikatën e datës 03.06.2010; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Pasqyrën e trustit të datës 27.09.2022 për ankuesen; Diplomën e datës 11.04.2018 me numër:5430; Diplomën e datës 18.03.2021 me numër:2539; Vërtetimin datës 09.10.2017; Referencën e datës 29.07.2019; Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit E.B; Shkresën plotësuese të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 13.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses
është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Mitrovicës, me datë 07.10.2022 ka shpallur konkurs për Specialist Ligjor, pozita e punës *Zyrtar për Bashkëpunim Profesional* me numër reference RN00010112 (*pranim*), ndërsa kritere e konkursit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar-Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ETC apo ekuivalente me to në Juridik/Drejtësi; dhe Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë punë në fushën për të cilën zhvillohet procedura e plotësimit e pozitës së lirë të punës.*

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja në konkursin përkatës ka aplikuar me numër të aplikacionit RAN0008853, ndërsa sipas Vendimit për verifikimin paraprak të datës 18.11.2022 të nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankueses i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk i ka përmbushur kriteret e konkursit, më pas ankuesja kundër vendimit për verifikimin paraprak të datës 18.11.2022 ka parashtruar ankesë të brendshme në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e cila më pas ka shqyrtuar ankesën e ankueses dhe përmes Vendimit të datës 23.11.2022 me shifër RAN0008853 ka refuzuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se e njëjta nuk e ka plotësuar njërin nga kriteret e konkursit siç është përvoja e punës në fushën e kërkuara të rekrutimit prej së paku dy (2) vitesh ngase sipas pasqyrës së llogarisë së gjendjes së trustit për ankuesen e njëjta ka dëshmuar vetëm njëzet e një (21) muaj përvojë të punës pas diplomimit, ngase ankuesja sipas Diplomës me



numër:3462/1220 të datës 01.12.2020 dëshmohet se me datë 30.09.2020 ka mbaruar studimet në Kolegjin Fama-Programi Juridik dhe ka marr titullin "LLB në Juridik" me gjithsejtë 240 kredi/ETC.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të goditur përmes kësaj ankese, ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlihen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë.", nga rrjedh se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin refuzimit të aplikacionit të ankueses në fazën e verifikimit paraprak ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe në kuptim të nenin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar", Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimit me shifër RAN0008853 i nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Mitrovicës së Jugut me datë 23.11.2022 është vendim i ligjshëm, mirëpo arsyetimi duhet ishte i ndryshëm.

Andaj, theksuar si më sipër në kuptim të nenit 13 të Rregullores Nr. 26/2020 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 2-Zyrtar i mesëm" ndërlihur me shtojcën Nr.1/9 ku përcaktohen kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një kandidatë për tu pranuar në këtë pozitë të shërbimit civil, janë si vijon: "Kërkesat e Përgjithshme Formale: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës", nga rrjedh se ankuesja në fakt përvojën e punës nuk e kishte në fushën e kërkuar për të cilën janë zhvilluar procedurat e rekrutimit, pasi që bazuar në shkresat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ankuesja është e vetëpunësuar apo udhëheq me biznesin e saj dhe sipas deklarimeve të saja në shkresën e datës 02.11.2022 nuk ka arritur të dëshmojë se cilat kanë qenë detyrat specifike në fushën e përvojës së punës e që ndërlihen me pozitën për të cilën ka aplikuar "Specialist Ligjor, pozita e punës Zyrtar për Bashkëpunim Profesional në kuadër të Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës", e që sipas konkursit të datës 07.10.2022 Fusha e njohurive , cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen kanë qenë: "Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve të tjera juridike; Njohuri të ligjeve dhe rregullave të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së komunës;", ndërsa Kërkesat e përgjithshme të nevojshme kanë qenë: "Njohuri e plotë dhe të specializuar në fushën profesionale specifike; nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlihen me detyrat dhe përgjegjësit;..."

Po ashtu, Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ndërlihur me plotësimin e kushteve dhe kriterëve nga kandidati tjetër në procedurë konkurruese E.B, ka gjetur se i njëjti në bazë të Diplomës me numër:5430 të datës 11.04.2018 dëshmohet se ka përfunduar studimeve universitare me datë 09.02.2018 në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti Juridik

dhe ka marr titullin Jurist i Diplomuar me gjithsejtë 240 kredi/ETC, po ashtu në bazë të Diplomës me numër:2539 të datës 18.03.2021 dëshmohet se ka përfunduar studimeve universitare Master me datë 25.02.2021 në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti Juridik dhe ka marr titullin LL.M (Master) Në Të Drejtën Ndërkombëtare, ndërsa sipas Vërtetimit të datës 01.04.2022 të lëshuar nga Noter Xhevat S. Veseli dëshmohet se i njëjti nga data 01.03.2021 deri me datë 01.03.2022 ka punuar në zyrën e noterisë dhe po ashtu sipas Vërtetimit të lëshuar nga Avokat Ujves S. Gashi i datës 02.07.2020 dëshmohet se i njëjti ka kryer praktikën e punës në pozitën e punës Bashkëpunëtor Profesional në periudhën kohore nga datat 01.07.2019 deri me datë 01.07.2020 dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se kandidati E.B i ka plotësuar kushtet e konkursit të datës 07.10.2022 ngase ka dy (2) vite përvojë pune profesionale pas diplomimit në fushën e kërkuar si dhe është i diplomuar në fushën përkatëse sipas kriterëve të konkursit.

Andaj, Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se ankesa e ankueses e datës 01.12.2022 është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa Vendimi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut i datës 23.11.2022 është vendim i ligjshëm ndërsa arsyetimi i të njëjtit është plotësuar përmes këtij vendimi dhe i njëjti ka mbetur në fuqi se në dispozitiv të këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1073/2022

Flakron GASHI



Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

